



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0189**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Agon Ramadani-Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) “Toni Ingjinjering” sh.p.k., me seli në Glllogoc, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit në fshatin Rudice” me nr. të prokurimit: 634-23-1044-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Kuvendi Komunal i Klinës, me datën 26.06.2023, mori këtë:

### **Vendim**

1. Aprovohet, pjesërisht si e bazuar ankesa e OE “Toni Ingjinjering” sh.p.k., me seli në Glllogoc, me nr. 2023/189 , e datës 06/04/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit në fshatin Rudice” me nr. të prokurimit:634-23-1044-5-2-1.
- 2.Mbetet në fuqi vendim i Autoritetit Kontraktues, i datës 24.03.2023, për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit të sipër shënuar.
- 3.Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
- 4.Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Toni Ingjinjering” sh.p.k.

### **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Me 16.02.2023, Kuvendi Komunal i Klinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë. Hapja e ofertave është bërë me datë 13.03.2023, ndërsa me datë 24.03.202,AK ka publikuar B58 njoftimin mbi vendimin për dhënie kontratës për aktivitetin e

prokurimit për aktivitetin e prokurimit Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit në fshatin Rudice” me nr. të prokurimit: 634-23-1044-5-2-1, ku është rekomanduar për kontratë “Construction Group”sh.p.k.

Me datë 28.03.2023, Operatori Ekonomik “Toni Ingjinjering” sh.p.k., me seli në Glllogoc, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim me datë 29.03.2023, AK Kuvendi Komunal i Klinës, e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues të datës 24.03.2023.

Me datën 24.02.2023, Operatori Ekonomik “Toni Ingjinjering” sh.p.k., ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 189/2023, kundër njoftimit mbi vendimin e AK për dhënie të Kontratës për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlerë e mesme. Vlera e parashikuar e kontratës: 30,000 €. Kriteri për dhënie të kontratës ishte: Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 17 prill 2023 me raportin e ekspertizës. AK Kuvendi Komunal i Klinës, me datë 20 prill 2023, ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërkaq me datë 18.04.2023, OE “Toni Ingjinjering” sh.p.k., ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

*- Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 17.04.2023, eksperti i jashtëm shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa OE “Toni Ingjinjering” sh.p.k., të aprovohet pjesërisht si e bazuar.

- mbetet në fuqi vendimi i AK-së i datës 24.03.2023

Përgjigje në Pretendimet ankimore të OE ankues

**REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES**

Duke u bazuar në sqarimet e mësipërme, eksperti i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e pjesërisht e bazuar, të mbetet në fuqi vendimi i AK-së për shpalljen e tenderuesit të suksesshëm.

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së

OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrirat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

*-Konstatimet dhe përfundimet e Panelit Shqyrtues*

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij paneli dhe si rrjedhojë paneli vendosi që ankesa OE “Toni Ingjinjering” sh.p.k., me seli në Gllogoc, të aprovohet pjesërisht si e bazuar, si dhe konform mendimit të raportit të ekspertit shqyrtues të mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin e AK-së i datës 24.03.2023.

Ndonëse mendimi i ekspertit nuk është detyrues, Paneli sipas mendimit të pavarur të tij e ka mbështetur raportin e ekspertit në rastin konkret, nisur nga parimi se vlera provuese e tij jepet gjithnjë me raport me vlerësimin, krahasimin dhe administrimin e të gjitha provave tjera dhe natyrën e një çështje në rastin konkret, lidhur me ankesën si objekt shqyrtimi në relacion me pretendimet ankimore të parashtruara në këtë ankesë, PSH deri tek vendim-marrja përfundimtare lka arritur duke konsideruar pikat kyçe përcaktuese të cilat kanë orientuar drejt vendimit sikur në dispozitiv, çështjet përcaktuese janë konsideruar çështjet e eliminimit të OE ankues nga ana e AK-së nga ky aktivitet prokurimi, konkretisht pretendimet e ndara nga ana e ekspertit, të paraqitura me nr rendor 2 dhe 3, kundrejt eliminimit të OE ankues.

Lidhur me pretendimin e dytë (II) ankimor, eksperti teknik ka konstatuar se:

Nga shqyrtimi i DT, konstatimi i OE ankues për kërkesën 3.1 del të jetë i qëndrueshëm. Formulimi i kësaj pike në DT është si në vijim “[...] *Vendim me shkrim mbi caktimin e një menaxheri të punishtes i vulosur dhe nënshkruar nga OE ne origjinal, kontrata valide kopje ose marrëveshje për angazhim në këtë projekt me punëdhënësin [...]*”. Siç shihet, nuk ka kërkesë për dëshmi për Menaxher të projektit, që është një kërkesë e zakonshme për projekte të tilla.

Sidoqoftë, kërkesa e DT për profilin e menaxherit të punishtes është e qartë, pra kërkohet që ai të jetë “*i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi – konstruktiv, së paku tri vite përvojë punë pas diplomimit*”. Ndërsa OE ankues ka caktuar një ing.dipl. të elektroteknikës si menaxher të punishtes.Lidhur me këtë pretendim, PSH ka gjetur se OE ankues siç ka konstatuar eksperti ka caktuar inxhinier të elektroteknikës ndërsa në kërkesë është specifikuar që kërkohet të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv, ndonëse OE ankues ka pretenduar se inxhinieri i paraqitur ka qenë i natyrës së këtij aktiviteti, PSH ka arritur në përfundim se megjithatë kjo është devijim nga kërkesa relevante duke mos përmbushur të njëjtën andaj, duke u nisur nga ky fakt Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë pretendim ankimor si dhe provave tjera të cituara më sipër përmes të cilave konfirmohet ky konstatim në raportin e ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i dytë (II) i Operatorit Ekonomik Ankues është pretendim i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e tretë (III) ankimor, eksperti teknik ka konstatuar se: “ *OE ankues pretendon që duke ofruar dy inxhinierë, njërin inxhinier të emergjencave dhe tjetrin të*

*certifikuar për siguri dhe shëndet në punë, oferta e tyre është në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e AK-së.*

*Megjithatë, Kërkesa 3.3 e DT specifikon që ofertuesit duhet kenë “një inxhinier apo master për Menaxhimin e emergjencave, Certifikuar për menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë”. Pra, kërkesa e DT qartazi kërkon që inxhinieri për menaxhimin e emergjencave të jetë i certifikuar për menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë. Kjo kërkesë nuk është përmbushur, prandaj pretendimi i OE ankues është i pabazuar.”, Duke u nisur nga faki parimor se në këtë kërkesë specifikohet lëmia e kërkuar profesionale dhe në këtë rast OE ankues mund të evidentohet se në ofertën e tij ka paraqitur dy persona që kanë poseduar nga një certifikatë relevante të kërkesës, ndërsa në kërkesë është specifikuar se një inxhinier duhet ti përmbajë diplomëm dhe certifikimin përkatës, për këtë arsye Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë pretendim ankimor si dhe provave tjera të cituara më sipër përmes të cilave konfirmohet ky konstatim në raportin e ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i tretë (III) i Operatorit Ekonomik Ankues është pretendim i pabazuar.*

Duke u bazuar në çështjet e mësipërme të shtjelluara, PSH ka konstatuar se OE ankues nuk ka arritur që të vërtetojë përgjegjshmërinë e ofertës së tij në aspektin e përmbushjes së kriterëve të kërkuara në DT, andaj edhe sikurse pretendimet tjera kundrejt eliminimit të tij të ishin të bazuara, përsëri nuk do të kishim rezultat tjetër përfundimtar, kështu që pretendimet tjera nuk është konsideruar se duhet të trajtohet në detaje nga ana e panelit sepse nuk do të ndikonin në ndonjë vendim-marrje tjetër, përveç tjerash vlen të theksohet se të gjithë OE të interesuar për ofertime në aktivitete prokurimi, në raste kur pretendohet lidhur me kriterë diskriminuese, të paqarta apo pretendime tjera lidhur me kërkesat e përpiluara në DT nga ana e AK, kanë mundësinë që të kërkojnë sqarime e poashtu të iniciojnë procedura ankimore (kërkesë për rishqyrtim, ankesë në OSHP), në periudhën para ofertimit, siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi.

Lidhur me çështjet e ngritura ndaj OE të rekomanduar për kontratë, PSH ka gjetur se lidhur me të njëjtat OE ankues ka pretenduar se OE i rekomanduar nuk ka plotësuar kërkesat e parashtruara në DT lidhur me përvojën e punës të stafit e poashtu lidhur me pikën 4.8, në të cilën është kërkuar platforma ngritëse, 4x4, lartësia 14m, PSH në këtë rast ka mbështetur konstatimin e ekspertit se : *Sipas Komisionit të vlerësimit, OE ankues ka ofruar pajisje e cila nuk është sipas specifikacionit teknik të DT për sa i përket pikës “4.8. Platform ngritëse, 4x4, Lartësia 14m.”. Ndërsa, Komisioni ka konstatuar që OE i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar të gjitha kërkesat lidhur me aftësinë teknike dhe profesionale dhe është cilësuar si ofertues i përgjegjshëm. Megjithëse edhe ky pretendim i OE ankues mund të cilësohet si i pabazuar, eksperti shqyrtues i rekomandon AK që, para se të vazhdoj me procedurat tjera në këtë aktivitet prokurimi, të verifikoj edhe një herë të gjitha dokumentet e kërkuara dhe të kërkoj sqarime shitesë (nëse është e nevojshme), në mënyrë që të sigurohet që OE i rekomanduar për kontratë i ka përmbushur plotësisht të gjitha kërkesat e DT. Një veprim i tillë mbase edhe është paraparë edhe me DT “AK rezervon të drejtën që me rastin e zgjedhjes së fituesit nëse e sheh të nevojshme të kërkojë verifikimin e të gjitha dokumenteve të kërkuara”. Andaj lidhur me këtë, duke pasur parasysh pretendimet ankimore në relacion me të gjitha provat e administruara nga ana e PSH, konstatohet se përgjegjësia e plotë lidhur me përmbushjen e kërkesave nga ana e OE të rekomanduar mbetet në AK, që përgjatë procedurave të mëtutjeshme sipas nevojës bashkarsisht me departamentet përkatëse të vërtetojë gjendjen faktike sipas pretendimeve të paraqitura nga ana e OE ankues, në këtë rast PSH konstaton se AK mund të aplikojë nenin 52 dhe 72 të LPP-së lidhur me vërtetimin e informacionit/dokumentacionit të dorëzuar si dhe kërkimin e informatave*

shtesë.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Agon Ramadani**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL I KLINËS**
- **OE - TONI INGJINJERING**
- Arkivës së OSHP-së: